



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI

Nr. 412/3 Prot.

Tiranë, më 01.03.2019

**VENDIM**  
Nr. 10 datë 01.03.2019

**MBI**

**MIRATIMIN E TESTEVE PRAKTIKE TË KONKURSIT PËR PRANIMIN E  
STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË UST**

Mbështetur në nenit 74/2, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 14 pika 6/z të Rregullores së UST-së, në shkresën nr. 253 prot, dt. 05.02.2019 të FSHL "Kërkesë për ndryshimin e normave të pranimit të Konkursit Praktik në FSHL dhe raporti teori-praktikë", në shkresën nr. 331 prot, dt. 15.02.2019 në FVFR "Përcjellje për miratim të Testeve të Konkursit të Pranimit për vitin akademik 2020-2021, Senati në mbledhjen e dt. 01.03.2019

**VENDOSI:**

1. Të lërë në fuqi testet praktike të vitit 2018-2019 edhe për vitin akademik 2019-2020 si për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes (FSHL) dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) (bashkangjitur).
2. Miratimin e Testeve Praktike të Konkursit për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes (FSHL) dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR), (bashkangjitur) për vitin akademik 2020-2021. Këto teste do përdoren në organizimin e konkurimit të kandidatëve për pranimet në programet e studimit në ciklin e parë "Bachelor".
3. Raporti i pikëve të fituara në konkurimin praktik dhe notës mesatare të shkollës së mesme për vitin akademik 2020-2021 të jetë 70% me 30%.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektorati, Dekanët e Fakulteteve, Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Agron ÇUKA

